

LIGJ
Nr. 7503, datë 26.7.1991

PËR STATUSIN E DEPUTETIT TË KUVENDIT POPULLOR

Në mbështetje të neneve 16 e 21 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
TË DREJTAT DHE DETYRAT E DEPUTETËVE

Neni 1

Deputeti i Kuvendit Popullor është përfaqësues i popullit në organin më të lartë të pushtetit shtetëror. Ai ka për detyrë t'u shërbejë me ndërgjegje popullit dhe atdheut në veprimtarinë e tij si deputet.

Neni 2

Deputeti ka të drejtë dhe detyrë të marrë pjesë rregullisht në mbledhjet e Kuvendit Popullor e të komisioneve të tij dhe të shprehë lirisht mendimet e tij dhe të zgjedhësve që përfaqëson nëpërmjet diskutimeve, propozimeve e debatit.

Ai ka të drejtë të marrë pjesë edhe në mbledhjet që organizohen nga organet shtetërore e ekonomike në rreth ose rajon.

Organet e pushtetit lokal në rreth ose rajon janë të detyruara, në fillim të çdo muaji, t'u venë në dispozicion deputetëve planet mujore të punës dhe kalendarin e mbledhjeve, duke përfshirë edhe ndryshimet eventuale që mund t'u bëhen atyre.

Neni 3

Deputeti kërkon shpjegime nga organet shtetërore e ekonomike dhe ndërhyt pranë tyre për zbatimin e përpiktë të dispozitave kushtetuese dhe të akteve ligjore e nënligjore.

Kur vëren se nëpunës apo punonjës të ndryshëm nuk i kryejnë detyrat apo shkelin ligjet ose aktet nënligjore, deputeti kërkon nga organet kompetente marrjen e masave përkatëse ndaj personave fajtorë. Këto organe janë të detyruara që brenda 15 ditëve të shqyrtojnë kërkesën dhe të njoftojnë deputetin për masat që kanë marrë.

Neni 4

Deputeti ka të drejtë t'u bëjë pyetje e propozime Këshillit të Ministrave, ministrive, drejtuesve të institucioneve qendrore, organeve të pushtetit, të administratës dhe të kërkojë shpjegime për çdo çështje që ka të bëjë me përmbushjen e detyrës. Këto organe janë të detyruara t'i shqyrtojnë pyetjet e propozimet e bëra dhe t'i përgjigjen deputetit brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së tyre.

Deputeti ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e organeve shtetërore ose ekonomike, kur shqyrtohen probleme të ngritura prej tij.

Neni 5

Drejtuesit e ministrive, të institucioneve qendrore dhe të organeve të tjera shtetërore dhe ekonomike detyrohen të presin në çdo kohë deputetin për problemet që lidhen me detyrën e tij.

Neni 6

Kur vëren që një akt i nxjerrë nga organet lokale të pushtetit e të administratës ose nga ministrinë e institucionet qendrore është i paligjshëm, deputeti kërkon revokimin ose shfuqizimin e tij. Organet përkatëse janë të detyruara që ta shqyrtojnë kërkesën e deputetit dhe brenda 20 ditëve ta venë atë në dijeni për përfundimin. Mosshqyrtimi i kërkesës së deputetit brenda këtij afati sjell si pasojë pezullimin e zbatimit të aktit.

Neni 7

Deputeti merr takim me zgjedhësit kur e çmon të nevojshme ose kur e kërkojnë zgjedhësit. Ai ka për detyrë t'u marrë mendimin zgjedhësve për projektet e materialet e tjera që shqyrton Kuvendi Popullor, t'u shpjegojë zgjedhësve ligjet dhe vendimet që ka nxjerrë Kuvendi Popullor, si dhe t'i njoftojë ata për problemet e rëndësishme politike, ekonomike e shoqërore që analizohen në mbledhjet e Kuvendit Popullor.

Kërkesat, ankesat, vërejtjet dhe propozimet e bëra nga zgjedhësit deputeti i parashtron në organet përkatëse, të cilat janë të detyruara t'i marrin në shqyrtim dhe brenda 1 muaji nga data e paraqitjes të njoftojnë deputetin për mënyrën e zgjidhjes së tyre.

Neni 8

Punëdhënësi detyrohet të lejojë deputetin të shkëputet nga puna, kur ai merr pjesë në mbledhjet e Kuvendit Popullor e të komisioneve të tij, në takimet me zgjedhësit ose kur dërgohet me shërbim prej Kuvendit Popullor.

Neni 9

Imuniteti i deputetit garantohej me dispozita kushtetuese.

Neni 10

Deputeti ka dokumentin e tij identifikues dhe shenjë dalluese, të cilat përdoren deri në mbarim të afatit të mandatit gjatë të cilit është zgjedhur deputet në Kuvendin Popullor.

Neni 11

Dokumenti identifikues zëvendëson çdo dokument tjetër si fletëhyrje, lejekalimi, leje kufitare etj., të lëshuar nga çdo organ shtetëror, civil e ushtarak ose privat në territorin e Republikës së Shqipërisë, për të hyrë në vende dhe objekte të ndryshme me përjashtim të atyre, hyrja në të cilat është e ndaluar me ligj.

KREU II TRAJTIMI I DEPUTETIT

Neni 12

Deputetit të Kuvendit Popullor, që ka pagën mujore deri në 1000 lekë, i njihet e drejta të marrë një shpërblim mujor prej 300 lekësh, ndërsa atij që ka pagën mujore mbi 1000 lekë i njihet e drejta të marrë një shpërblim mujor prej 200 lekësh.

Neni 13

Deputeti i pasistemuar në punë shpërblehet me një pagë mujore në masën 80 për qind të pagës mesatare të tij të vitit të fundit.

Deputeti që është student shpërblehet me një pagë mujore në masën 600 lekë.
Këtyre deputetëve u njihen të gjitha të drejtat e tjera që parashikon ky ligj.

Neni 14

Deputeti, që nuk banon në qytetin e Tiranës, merr një dietë ditore prej 40 lekësh gjatë kohës që merr pjesë në mbledhjet e Kuvendit Popullor ose të komisioneve të tij.

Deputeti merr një dietë ditore prej 40 lekësh kur shkon jashtë rrethit për të marrë takim me zgjedhësit e zonës së tij ose dërgohet me shërbim nga Kuvendi Popullor.

Fjetja i sigurohet në çdo rast dhe i paguhet sipas dëftesës përkatëse.

Neni 15

Deputeti, kur dërgohet me shërbim jashtë shtetit merr një dietë ditore, ashtu si funksionarët shtetërorë të kategorisë së parë.

Neni 16

Deputetit i njihet e drejta të pajiset me pasaportë diplomatike, kur shkon jashtë shtetit.

Neni 17

Deputetit i sigurohet me përparësi sipërfaqe banimi, sipas normave ekzistuese ligjore që veprojnë për gjithë shtetasit e tjerë.

Neni 18

Deputeti, krahas lejes së zakonshme i njihet e drejta e një leje të veçantë të pagueshme vjetore prej 7 ditësh.

Neni 19

Deputeti nuk i nënshtrohet kontrollit doganor si individ për rastet kur hyn e del nga territori i Republikës së Shqipërisë, po kështu dhe bagazhet e tij.

Nuk i nënshtrohen kontrollit doganor edhe koltë e paketat që vijnë nga jashtë shtetit në emër të deputetëve në rrugë postare, ajrore, detare e tokësore ose me anë të personave të tretë.

Neni 20

Deputetit i njihet e drejta të udhëtojë pa pagesë me të gjitha mjetet e transportit shtetëror.

Kur deputeti do të udhëtojë për të marrë pjesë në mbledhje të Kuvendit Popullor, të komisioneve ose në takim me zgjedhësit, komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit detyrohet t'i sigurojë automjet.

Neni 21

Në çdo rreth ose rajon hapet një zyrë e veçantë pune për deputetët pranë komitetit ekzekutiv të këshillit popullor përkatës. Në shërbim të deputetëve të çdo rrethi ose rajoni caktohet një sekretar, si rregull, me arsim juridik.

Neni 22

Deputetit i njihet e drejta të pajiset me numër telefoni. Për shpenzimet e bisedimeve telefonike deri në 50 lekë në muaj, ai nuk paguan.

Neni 23

Deputeti përfshihet në protokollin e rrethit, ku banon ose ku është zgjedhur, në të gjitha veprimtaritë politiko-artistike dhe sportive, si dhe në protokollin e shtetit sipas rregullave të caktuara me dispozita të veçanta.

Neni 24

Deputeti merr falas kopje të ligjeve të miratuara nga Kuvendi Popullor, të urdhëresave e vendimeve të Këshillit të Ministrave, si dhe të akteve nënligjore të nxjerra nga organet lokale të pushtetit e administratës në rrethin ku është zgjedhur.

Gazeta Zyrtare dhe buletinet e nxjerra nga Kuvendi Popullor i dërgohen pa pagesë çdo deputeti.

Neni 25

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë dispozitat përkatëse për zbatimin e këtij ligji.

KREU III DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 26

Dekreti nr.4322, datë 10.10.1967 "Për dietat e deputetëve të Kuvendit Popullor", shfuqizohet.

Neni 27

Ky ligj hyn në fuqi më 16 prill 1991.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
RAMIZ ALIA